



Canon

SIGURIA E INFORMACIONIT ME eMAINTENANCE TË CANON-IT

eMaintenance e Canon-it kujdeset për menaxhimin dhe administrimin e të gjitha pajisjeve tuaja Canon, të lidhura në rrjet me MFP-në dhe SFP-në, duke ndjekur protokollet e repta të sigurisë.

PJESA 1: PYETJE TË SHPESHTA

Ky dokument synon t'u përgjigjet pyetjeve kryesore për sigurinë që mund të keni në lidhje me eMaintenance. Për informacion të mëtejshëm lidhur me sigurinë e integruar në eMaintenance, kontaktoni përfaqësuesin lokal të Canon-it.



Kush i zotëron të dhënat e mia?

Në të gjitha rastet, të dhënat tuaja zotërohen nga ju, Canon-i është vetëm përpunuesi i miratuar i të dhënave të klientit në eMaintenance.



Kush mund t'i aksesojë të dhënat e mia?

Canon-i ofron qasje të shtresëzuar për rregullimin e aksesit në të dhëna, duke përfshirë:

- **Kontrolle të aksesit fizik** – Vetëm personat e autorizuar lejohen të kenë akses fizik te mjediset, godinat ose sallat e ruajtjes së të dhënave personale.
- **Kontrollet e aksesit në sistem** – Sistemet që përpunojnë të dhënat personale mund të aksesohen vetëm me autorizim të bazuar në rolet e përdoruesit dhe me lejet përkatëse.
- **Kontrollet e aksesit në të dhëna** – Personat që kanë të drejtë të përdorin sistemet e përpunimit të të dhënave, marrin akses vetëm te të dhënat personale që ata kanë të drejtë të aksesojnë.
- **Kontrollet e transmetimit të të dhënave** – Përveçse kur është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve në përputhje me marrëveshjen përkatëse, të dhënat personale nuk duhet të lexohen, kopjohen, modifikohen ose të hiqen pa autorizim, gjatë transferimit.
- **Kontrollet e hedhjes së të dhënave** – Canon-i zbaton masa të cilat mundësojnë në mënyrë prapavepruese ekzaminimin dhe përcaktimin nëse dhe nga kush janë hedhur, modifikuar ose hequr të dhënat personale nga sistemet e përpunimit të të dhënave të Canon-it.

- **Kontrollet e punës** – Të gjithë punonjësit e Canon-it, nënpërpunuesit e kontraktuar ose ofruesit e tjerë të shërbimit, janë të detyruar sipas kontratës që të respektojnë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve delikate.
- **Kontrollet e ndarjes së të dhënave** – Të dhënat personale ruhen dhe aksesohen vetëm nga përdoruesi individual i eMaintenance të klientit.

Aksesi në të dhëna kontrollohet duke marrë masat e mëposhtme:

- Si pjesë e Politikës së Sigurisë së Canon-it, të dhënat personale kërkojnë të paktën të njëjtin nivel mbrojtjeje si informacioni “konfidencial”.
- Aksesi në të dhëna personale jepet vetëm në rast se ekziston nevoja për të pasur informacion. Personeli ka akses tek informacioni që i duhet për të përmbushur detyrën.
- Masat e sigurisë që mbrojnë aplikacionet e përpunimit të të dhënave personale kontrollohen rregullisht. Për këtë qëllim, Canon-i kryen kontrolle të brendshme dhe të jashtme të sigurisë, dhe teste depërtimi në sistemet e veta të IT-së.
- Të dhënat personale nuk duhet të lexohen, kopjohen, modifikohen ose të hiqen pa autorizim gjatë kohës së përpunimit, përdorimit dhe ruajtjes.



A janë të dhënat e mia të enkriptuara?

Të dhënat e ruajtura në shërbimin e resë kompjuterike AWS janë të enkriptuara.

Kur të dhënat transferohen mes Canon-it dhe klientëve të tij, ky veprim kryhet gjithmonë përmes protokolleve të transferimit me enkriptim të sigurt.

Të dhënat personale që mund të ruhen kur përdoret shërbimi opsional i krijimit të kopjes rezervë të të dhënave ose shërbimi i mbështetjes së instalimit, si p.sh. të dhënat e adresarit të pajisjes, enkriptohen duke përdorur AES-256.



Si ndahen të dhënat e mia nga të dhënat e klientëve të tjerë?

Të dhënat personale përpunohen duke ndjekur kontrollet e mëposhtme të ndarjes:

Canon-i përdor kontrolle të përshtatshme teknike për të arritur ndarjen logjike të të dhënave të klientit.

Ku është e zbatueshme, struktura e degëzuar me shumë shtresa i siguron përdoruesit kryesor që të ketë akses te nënpërdoruesit e tij, megjithëse nënpërdoruesit nuk mund të ketë akses te përdoruesit të tjerë të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë (si p.sh. niveli i përdoruesve kryesorë).



Çfarë të dhënash mbledhen nga eMaintenance?

Shumica e të dhënave të mbledhura dhe të përdorura nga eMaintenance janë të dhëna jopersonale të identifikueshme nga pajisja, si p.sh. klienti, emri i pajisjes, numri i serisë, vendndodhja, adresa IP, statusi dhe njoftimet.

Informacioni i mëposhtëm nuk mbledhet nga eMaintenance: informacioni në lidhje me operimin e përdoruesit, si emri i përdoruesit*, data/ora, emri i dokumentit, përmbajtja e punës (të dhënat e imazhit/printimit) në rast KOPJIMI, PRINTIMI, SKANIMI dhe DËRGIMI.



A e auditon Canon-i sigurinë në renë e vet kompjuterike?

Canon-i kryen audite të ndryshme si tregues të statusit të zbatimit të sigurisë së informacionit të shërbimeve që ofron në renë kompjuterike, në mënyrë që të sigurohet se Canon-i dhe klientët e tij të mund t'i përdorin shërbimet me besim.

Për të verifikuar masat e sigurisë së eMaintenance, një palë e tretë kryen rregullisht teste depërtimi.

*Gjatë përdorimit të shërbimit opsional të krijimit të kopjes rezervë të të dhënave ose shërbimit të mbështetjes së instalimit, mund të mbledhen të dhëna si emri i përdoruesit ose adresa e email-it nëse gjenden në adresarin e pajisjes, por vetëm me marrëveshje të veçantë me klientin.





A është infrastruktura e resë kompjuterike të eMaintenance e sigurt?

Shërbimi eMaintenance mbahet në platformën AWS, me vendndodhje në Frankfurt, Gjermani.



A ka eMaintenance ndonjë certifikim kundrejt ndonjë standardi të rëndësishëm të sigurisë?

Qendra e Zhvillimit të Printimit Dixhital të Canon Inc. është e certifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 27001. Certifikimi i marrë lidhet me zhvillimin e Shërbimit të Monitorimit të Canon Inc.(duke përfshirë eMaintenance Suite) për pajisjet shumëfunksionale (MFD) dhe printerët.

Me marrjen e ISO/IEC 27001 dhe ISO/IEC 27017, Canon Inc. mund të konfirmojë se proceset e tij të sigurisë janë të certifikuara nga palë të treta sipas një standardi të njohur ndërkombëtarisht.

Ky standard demonstroi përkushtimin e Canon Inc. ndaj sigurisë së informacionit brenda kompanisë dhe të shërbimeve online që ofrojmë:

- **Konfidencialitet** – siguria se informacioni është i aksesueshëm vetëm nga personat e autorizuar.
- **Integritet** – mbrojtja e saktësisë dhe plotësisë së informacionit dhe të mënyrave të përpunimit.



- **Disponueshmëri** – siguria se përdoruesit e autorizuar kanë akses në informacion, kur nevojitet.

ISO/IEC 27001 kërkon rishikim të rregullt dhe nënkupton se funksionet e shërbimit të monitorimit po zhvillohen dhe ofrohen nga një organizatë e sigurt, e cila është konfirmuar nga certifikime të palëve të treta sipas standardeve të dakordësuara ndërkombëtare.

ISO/IEC 27001 përfshin pjesërisht edhe ISO/IEC 27017, e cila përcakton kontrollet shtesë të sigurisë, veçanërisht për ofruesit e shërbimit të resë kompjuterike. Standardi përcakton kuadrin e sigurisë së informacionit për organizatat që përdorin shërbimet e resë kompjuterike.

Canon-i ka zgjedhur ta respektojë këtë kod praktike për kontrollet e sigurisë së informacionit, sepse klientët e shërbimit të resë kompjuterike janë më të sigurt kur ofrohet një qasje konsistente dhe gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë së informacionit.

LEGJENDA


CCA - Agjenti i Lidhjes me Renë Kompjuterike

CDCA - Agjenti i Canon-it për Mbledhjen e të Dhënave

RMT. DIAG. MEAP - Diagnostikimi MEAP nga Distanca

eRDS - Sistemi i Diagnostikimit nga Distanca i integruar

RDMS - Shërbimi i Shpërndarjes dhe Menaxhimit nga Distanca



PJESA 2: KËRKESAT E INFRASTRUKTURËS SË eM

eM përdor disa agjentë lokalë dhe aplikacione softuerike për të mundësuar komunikimin mes pajisjeve të Canon-it dhe shërbimit eM. Në varësi të një serie faktorësh, si lloji i pajisjes, konfigurimi i infrastrukturës lokale dhe kërkesat e shërbimit, secili klient mund të aktivizojë një ose më shumë prej tyre.

Opsionet janë si më poshtë:

CCA (Agjenti i Lidhjes me Renë Kompjuterike)

CCA-ja është agjenti më i fundit i integruar në pajisje për eMaintenance, i cili vepron brenda në pajisje pa qenë nevoja që në rrjetin tuaj të instalohet një agjent i veçantë për mbledhjen e të dhënave. Duke qenë se mund të mbledhë një gamë më të gjerë të të dhënave të pajisjes, lidhja me CCA-në nevojitet për të përfituar nga të gjitha funksionet dhe shërbimet më të fundit (dhe të ardhshme) të eMaintenance, duke përfshirë Diagnozën e Parashikuar me IA dhe Riparimin. CCA-ja mund të shtohet në pajisjet ekzistuese që përdorin eRDS.

CDCA (Agjenti i Canon-it për Mbledhjen e të Dhënave)

Ky është një agjent i instaluar në kompjuter për eMaintenance. Ky softuer monitorimi është i instaluar në një kompjuter lokal në rrjetin e klientit.

RMT. DIAG. MEAP (Diagnostikimi MEAP nga Distanca)

Ky është një agjent softuerik i integruar në pajisje për eMaintenance që përdor platformën MEAP, e cila mund të përdoret për të monitoruar pajisjen pritëse dhe pajisje të tjera të Canon-it në rrjet. Ideal për rrjete më të vogla, të cilat nuk kërkojnë server CDCA.

eRDS (Sistemi i Diagnostikimit nga Distanca i integruar)

eRDS është një agjent i hershëm i integruar në pajisje për eMaintenance. Softueri i monitorimit vepron brenda vetë pajisjes. eRDS dërgon informacion për menaxhimin e pajisjes të shërbimi eMaintenance dhe mund të konfigurohet për të marrë përditësime të licencave të firmuerit dhe të aplikacionit MEAP.

RDMS (Shërbimi i Shpërndarjes dhe Menaxhimit nga Distanca)

Aktivizon ofruesit e autorizuar të shërbimit të Canon-it për të menaxhuar produktet dhe licencat për aplikacionet MEAP dhe opsionet iR, si edhe për përditësimin e licencave të firmuerit dhe aplikacionit MEAP.

Shërbimi i Krijimit të Kopjes Rezervë të të Dhënave

Ky shërbim opsional dërgon në renë kompjuterike kopjen rezervë të planifikuar rregullisht për cilësimet e ruajtura në pajisjen ruajtëse të brendshme në formë të enkriptuar. Në rast të dështimit të HDD-së/SSD-së/Kontrolluesit për të cilin kërkohet zëvendësim, shërbimi i krijimit të kopjes rezervë të të dhënave mund t'i rikthejë të dhënat në pajisje duke reduktuar ndjeshëm kohën e riparimit.

Aksesi i Kërkuar në Rrjet

Për të mundësuar funksionimin e eMaintenance, klientëve do t'u kërkohet të lejojnë aksesin në URL të përshtatshme, të disponueshme për pajisjet Canon nëpërmjet rrjetit të tyre. Kërkohet përfaqësuesit tuaj të Canon-it listën e URL-ve specifike të kërkuara për mjedisin tuaj.

URL-TË INDIVIDUALE TË LIDHJES ME eMAINTENANCE

Canon-i rekomandon përdorimin e karaktereve të veçanta (wildcards) në përjashtimet e Firewall-it, si:
 *.srvygles.com *.amazonaws.com
 *.c-cdsknn.net *.ugwdevice.net

CCA	
hbp-ecl.srvygles.com - Porta 443	rgt.srvygles.com - Porta 443
kinesis.eu-central-1.amazonaws.com - Porta 443	camapi.srvygles.com - Porta 443
cognito-identity.eu-central-1.amazonaws.com - Porta 443	camapi-ecl.srvygles.com - Porta 443
a2etju7iemltgc-ats.iot.eu-central-1.amazonaws.com - Porta 443 ose Porta 8883	hbpm-ecl.srvygles.com - Porta 443
CDCA v1.XX	
b01.ugwdevice.net	
Versioni CDCA v2.XX dhe më i ri (modaliteti standard)	Versioni CDCA v2.XX dhe më i ri (modaliteti CCA)
rgt.srvygles.com	hbp-ecl.srvygles.com
hbpm-ecl.srvygles.com	kinesis.eu-central-1.amazonaws.com
camapi-ecl.srvygles.com	cognito-identity.eu-central-1.amazonaws.com
camapis-ecl.srvygles.com	a2etju7iemltgc-ats.iot.eu-central-1.amazonaws.com
camapi.srvygles.com	rgt.srvygles.com
camapis.srvygles.com	hbpm-ecl.srvygles.com
mds-ecl.srvygles.com	camapi-ecl.srvygles.com
gdlp01.c-wss.com	camapis-ecl.srvygles.com
www-ecl.srvygles.com	camapi.srvygles.com
cam-ecl.srvygles.com	camapis.srvygles.com
	mds-ecl.srvygles.com
	gdlp01.c-wss.com
	www-ecl.srvygles.com
	cam-ecl.srvygles.com
Për RMT, DIAG, MEAP (modaliteti CCA v4.0 dhe më i ri)	Për RMT, DIAG, MEAP (Modaliteti HTTP)
hbp-ecl.srvygles.com	a01.ugwdevice.net - Porta 443
kinesis.eu-central-1.amazonaws.com	b01.ugwdevice.net - Porta 443
cognito-identity.eu-central-1.amazonaws.com	
a2etju7iemltgc-ats.iot.eu-central-1.amazonaws.com	
rgt.srvygles.com	
hbpm-ecl.srvygles.com	
camapis-ecl.srvygles.com	
camapis.srvygles.com	
camapi-ecl.srvygles.com	
camapi.srvygles.com	
mds-ecl.srvygles.com	
eRDS	
a01.ugwdevice.net - Porta 443	
b01.ugwdevice.net - Porta 443	
cnvextdata-anls.srvygles.com - Porta 443 kërkohet vetëm për aktivizimin nga distanca të CAA-së në pajisjet ekzistuese me eRDS	
Për RDMS	
device.c-cdsknn.net - Porta 443	a02.c-cdsknn.net - Porta 443
device02.c-cdsknn.net - Porta 443	
Për Shërbimin e Krijimit të Kopjes Rezervë të të Dhënave	
hbp-ecl.srvygles.com - Porta 443	b01.ugwdevice.net - Porta 443
kinesis.eu-central-1.amazonaws.com - Porta 443	cnvextdata-anls.srvygles.com - Porta 443
cognito-identity.eu-central-1.amazonaws.com - Porta 443	camapi-ecl.srvygles.com - Porta 443
a2etju7iemltgc-ats.iot.eu-central-1.amazonaws.com - Porta 443 ose Porta 8883	camapis-ecl.srvygles.com - Porta 443
rgt.srvygles.com - Porta 443	camapi.srvygles.com - Porta 443
hbpm-ecl.srvygles.com - Porta 443	camapis.srvygles.com - Porta 443
a01.ugwdevice.net - Porta 443	dcf-ecl.srvygles.com - Porta 443

Shkurt 2025 - V.01



Canon Inc.
canon.com

Canon Europe
canon-europe.com

Albanian edition
© Canon Europa N.V. 2025

Canon Europe Limited
4 Roundwood Avenue
Stockley Park
Uxbridge
UB11 1AF